



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 174 prot.

Kamëz, më 09.12.2022

V E N D I M
Nr. 149 .Datë 09/12 2022
M B I

“SHQYRTIMIN DHE KONFIRMIMIN E LEJEVE TË ZHVILLIMIT/LEJEVE TË NDËRTIMIT PARA ZBARDHJES SË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 09.12.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.131 Datë 09.12.2022 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja “b”, nenit 23, pika 14 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2016 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 29 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar); VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit”(i ndryshuar); VKM-së nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin dhe shqyrtimin e dosjeve të aplikimeve për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi të aplikuara në sistemin **e-leje** deri në datë 16.11.2022 të bëhen duke u bazuar ne rregullat dhe kriteret ligjore sipas planit të mëparshëm vendor nr. 8 KKT datë 20.12.2012.
2. Ngarkohen për zhvillimin e procedurave të mëtejshme Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Kamëz.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

